



Nr. ____ prot.

Tiranë, më __. __. 2023

Lënda: Mbi kërkesën për informacion mbi transferimet e përhershme në përfundim të afatit të pezullimit nga shërbimi civil

ZNJ. MIRANDA ALLKJA

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj protokolluar me tonën nr. 4484 prot., datë 06.09.2023, përmes së cilës, keni parashtruar disa pyetje mbi transferimin e përhershëm në përfundim të pezullimit të nëpunësve civilë, referuar ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Për pyetjen 1, 2, 3 dhe 4, nëse gjatë vitit 2023, referuar institutit të transferimit të përhershëm në përfundim të pezullimit nga shërbimi civil, janë kryer transferime të nëpunësve civilë në “pozicione të njëjta” dhe në “pozicione të ngjashme” dhe sa prej tyre i përkasin këtyre të fundit, informojmë se, referuar gërmës “c” të nenit 49 dhe nenit 56, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Kreut II të VKM nr.124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil”, i ndryshuar, në përfundim të afatit apo zhdukjes së shkakut të pezullimit, nëpunësi civil rikthehet në pozicionin e mëparshëm të punës, nëse ky pozicion është vakant, ose transferohet në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori, në rast se pozicioni i mëparshëm është plotësuar përfundimisht. Në rast se njësia përgjegjëse gjendet në kushtet e pamundësisë së sistemimit, vendos regjistrimin e nëpunësit civil në listë. Nëpunësi civil qëndron në listë deri në sistemimin e tij në një pozicion të rregullt të shërbimit civil.

Nga të dhënat që administrojmë, rezulton se, deri tani, për vitin 2023, 14 nëpunës civil janë rikthyer në pozicionin e mëparshëm në përfundim të pezullimit dhe 20 nëpunës civil janë transferuar në përfundim të pezullimit, në një pozicion tjetër, brenda së njëjtës kategori.

Ju bëjmë me dije se, për asnjë nga rastet e transferimit të përhershëm të nenit 49 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk parashikohet transferimi i përhershëm në pozicione të ngjashme.

Për pyetjen 5, 6 dhe 7, theksojmë se, njësia përgjegjëse për shqyrtimin e mundësisë të sistemimit, në përfundim të pezullimit të nëpunësit civil, bazohet tek neni 56 i ligjit nr.15/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në Kreun II, të VKM nr.124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil”, i ndryshuar,

Metodologjia e vlerësimit dhe sistemi i pikëzimit, parashikuar në Udhëzimin nr.1, datë 1.03.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për

shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, i ndryshuar, gjen zbatim vetëm në rastin e transferimit të përhershëm për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit.

Për pyetjen 8 dhe 9, sqarojmë se, referuar Vendimit nr.305, datë 5.04 2017 “Për disa shtesa në Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës, në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, pozicionet e punës që bëjnë pjesë në grupin e pozicioneve, pjesë të strukturave horizontale, kanë të njëjtë, vetëm, kriteret e pranimit dhe përshkrimin e përgjithshëm të punës

Referuar vendimit të sipërcituar, çdo pozicion ka përshkrimin e vet të punës, ku përcaktohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të pozicionit respektiv të punë, cili hartohet nga drejtuesi i njësisë organizative përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore, në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit respektiv të punës.

Sjellim në vëmendjen tuaj se, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore shqyrton dhe vlerëson mundësinë e sistemimit në përfundim të pezullimit të nëpunësit civil, në një pozicion të së njëjtës kategori, bazuar në përshkrimin e punës. Ndërkohë për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore njësi përgjegjëse për sistemimin e nëpunësve në përfundim të pezullimit është njësia e burimeve njerëzore e institucionit respektiv.

Faleminderit për mirëkuptimin.

